

**VENDIM**  
**Nr. 686, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN**  
**DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO**  
**NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE**  
**BANESAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2.4, të vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.5, me këtë përmbajtje:

“2.5. Përveç përcaktimeve të pikës 2.4, të këtij vendimi, fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2023, do të jetë në masën 1 662 450 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili do t'i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**